



Originali: **Anglisht**

No.: ICC-02/05-01/07

Data: 27 Prill 2007

DHOMA E SEANCËS PARAGJYQËSORE I

**DHOMA I E SEANCËS PARAGJYQËSORE: Gjyqtare Akua Kuenyehia
, Kryetare e Trupit Gjykues
Gjyqtar Claude Jorda
Gjyqtare Sylvia Steiner**

Regstrar:

Mr Bruno Cathala

**SITUATA NË DARFUR, SUDAN
NË ÇËSHTJEN E PROKURORIT kundër
AHMAD MUHAMMAD HARUN ("AHMAD HARUN") dhe
ALI MUHAMMAD ALI ABD-AL-RAHMAN ("ALI KUSHAYB")**

Dokument Publik

URDHËR-ARREST PËR ALI KUSHAYB

Zyra e prokurorit

z. Luis Moreno Ocampo; Prokuror
zsh. Fatou Bensouda, Zëvendës Prokuror
z. Andrew Cayley, Avokat i lartë i të
drejtës gjyqësore
z. Ade Omofade, Avokat i të drejtës
gjyqësore

DHOMA E SEANCËS PARAGJYQËSORE I e Gjykatës Penale Ndërkombëtare (“Dhoma” dhe “Gjyqi”, përkatësisht);

PASI KA SHQYRTUAR “Kërkesën e Prokurorit në bazë të nenit 58(7)” (“Kërkesa e Prokurorit”), në lidhje me Ahmad Muhammad HARUN (“Ahmad Harun”) dhe Ali Muhammad Ali ABD-AL-RAHMAN (“Ali Kushayb”), të dorëzuar më 27 shkurt 2007, dhe materialet dhe dëshmitë e tjera të dorëzuara nga Prokuroria;¹

DUKE PASUR PARASYSH “Vendimin e kërkesës së Prokurorit në bazë të Nenit 58(7) të Statutit”² përmes së cilës Dhoma konsideron se nuk është e kënaqur që ftesa për t’u paraqitur në gjyq është e mjaftueshme për të siguruar paraqitjen para gjyqit të Ali Kushayb’s, dhe që arrestimi i tij duket të jetë i domosdoshëm, në bazë të nenit 58(1)(b) të Statutit të Romës (“Statuti ”);

DUKE PASUR PARASYSH nenet 19 dhe 58 të Statutit;

DUKE KONSIDERUAR që, në bazë të evidencës dhe informacionit të ofruar nga Prokurori dhe pa paragjykuar ndonjë sfidë në lejueshmërinë e rastit sipas nenit 19(2) (a) dhe (b) të Statutit dhe pa paragjykuar ndonjë përcaktim pasues, rasti kundër Ali Kushayb dhe Ahmad Harun ndodhet brenda juridiksionit të gjykatës dhe është i pranueshëm;

¹ ICC-02/05-62-US-Exp; ICC-02/05-64-US-Exp; ICC-02/05-69-US-Exp; dhe ICC-02/05-72-US-Exp.

² ICC-02/05-01/07-1

DUKE KONSIDERUAR që ka bazë të arsyeshme të besohet se që nga gushti 2002 gjer në kohën, që të paktën ka lidhje me kërkesën e prokurorit, ka ndodhur një konflikt i zgjatur i armatosur, sipas kuptimit të nenit 8(2)(f), ndërmjet Qeverisë së Sudanit, duke përfshirë luftëtarët nga Forcat e Armatosura Popullore të Sudanit “Forcat e Armatosura të Sudanit” dhe Forcës për Mbrojtje Popullore (“FMP”) së bashku me Milicët/Janjaweed kundër grupeve të organizuara rebele, që përfshijnë Lëvizjen/Armatën Për Çlirimin e Sudanit (L/A CS) dhe Lëvizjen për Drejtësi dhe Barazi (LDB) në Darfur, Sudan;

DUKE KONSIDERUAR që ka bazë të arsyeshme të besohet se Forcat e Armatosura Sudaneze dhe Milicët/Janjaweed, duke vepruar së bashku si pjesë e fushatës kundër rebelimit, kryen disa sulme në qytetet Kodoom, Bindisi, Mukjar, Arawala dhe zonat përreth, për një periudhë të gjatë kohore të paktën midis viteve 2003 dhe 2004, ndonëse këto qytete ishin të lira nga çfarëdo aktiviteti i rebelëve dhe ndonëse popullata nuk merrte pjesë aktive në ndonjë nga veprimet ushtarake.

DUKE KONSIDERUAR që ka bazë të arsyeshme të besohet se gjatë këtyre sulmeve Forcat e Armatosura të Sudanit dhe Milicët/Janjaweed, kryen në periudhën midis gushtit 2003 dhe marsit 2004, disa akte kriminale kundër civilëve që kryesisht ishin nga popullata Fur, Zaghawa dhe Masalit, përkatësisht vrasje të civilëve, përdhunime dhe shkelje të dinjitetit të grave dhe vajzave, sulme të drejtuara qëllimisht kundër popullatës civile të sipërpërmendur dhe shkatërrimin e pronës që i takonte popullatës së sipërpërmendur dhe shndërrimin e qyteteve në gërmadha.

DUKE KONSIDERUAR që ka bazë të arsyeshme që të besohet se, gjatë sulmeve të sipërpërmendura, janë kryer krime lufte që përfshihen nën juridiksionin e gjykatës, në bazë të neneve 8(2)(c)(i), 8(2)(c)(ii), 8(2)(e)(i), 8(2)(e)(v), 8(2)(e)(vi), dhe 8(2)(e)(xii) të Statutit, siç përshkruhet në kërkesën e Prokurorit;

DUKE KONSIDERUAR që ka bazë të arsyeshme që të besohet se sulmet e kryera nga Forcat e Armatosura Sudaneze dhe/ose Milicia/Janjaweed ishin të një natyre sistematike ose të gjerë dhe ishin të drejtuara kundër civilëve, kryesisht nga popullata Fur, Zaghawa dhe Masalit, në vijim të, ose në mbështetje të një politike Shtetërore ose organizative që përbëhej nga sulmet e popullatës civile;

DUKE KONSIDERUAR që ka bazë të arsyeshme të besohet se gjatë këtyre sulmeve, të kryera nga ana e Forcave të Armatosura të Sudanit dhe Milicia/ Janjaweed, janë bërë persekutime, vrasje, zhvendosje të dhunshme, burgime ose heqje të ashpra të lirive, akte të torturës, dhunime dhe akte të tjera jo humane ndaj civilëve kryesisht nga popullatat Fur, Zaghawa dhe Masalit;

DUKE KONSIDERUAR që ka bazë të arsyeshme të besohet se gjatë sulmeve të sipërpërmendura janë kryer krime kundër njerëzimit që përfshihen nën juridiksionin e Gjykatës, në bazë të neneve 7(1)(a), 7(1)(d), 7(1)(e), 7(1)(f), 7(1)(g), 7(1)(h) dhe 7(1)(k) të Statutit, siç përshkruhet në Kërkesën e Prokurorit;

DUKE KONSIDERUAR që ka bazë të arsyeshme të besohet se Ali Kushayb ishte një nga liderët kryesor në hierarkinë fisnore në lokalitetit Wadi Salih dhe anëtar i PDF-së dhe që ka komanduar mijëra Milicë/Janjaweed nga, ose gjatë gushtit 2003 deri në, ose rreth marsit 2004;

DUKE KONSIDERUAR se ka bazë të arsyeshme të besohet se si anëtar i PDF-së dhe udhëheqës i lartë i Milicisë/Janjaweed, Ali Kushayb ka implementuar strategjinë kundër rebelimit të Qeverisë së Sudanit që rezultoi gjithashtu në kryerjen e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit në Darfur, Sudan, siç përshkruhet më sipër;

DUKE KONSIDERUAR se ka bazë të arsyeshme të besohet se Ali Kushayb, i cili ishte caktuar si »ndërmjetës» në mes të liderëve të Milicisë/Janjaweed dhe Qeverisë së Sudanit, gjithashtu rekrutonte luftëtarët, armatoste, financonte dhe u ofronte ushqime dhe furnizime të tjera Milicisë/Janjaweed që ishte nën komandën e tij, kështu që qëllimisht kontribuoi në kryerjen e krimeve të sipërpërmendura, në mbështetje të planit të përbashkët të kryer nga Forcat e Armatosura të Sudanit dhe Milicia/Janjaweed, e që kishin të bënin me sulmimin e popullatës civile në Darfur;

DUKE KONSIDERUAR se ka bazë të arsyeshme të besohet se si një nga liderët e Milicisë/Janjaweed, që vepronin së bashku me Forcat e Armatosura të Sudanit, Ali Kushayb mori pjesë personalisht në disa nga sulmet kundër civilëve, përkatësisht në qytetet Kodoom, Bindisi, Mukjar dhe Arawala, midis gushtit 2003 dhe marsit 2004, ku kanë ndodhur vrasje të civilëve, dhunime, tortura dhe trajtime të tjera të egra, rrënimi i qyteteve dhe shkatërrimi i pronës së popullatës civile, dhe që si pasojë ai, në bashkëpunim me të tjerët, ka kryer krimet për të cilat akuzohet.

DUKE KONSIDERUAR se për të gjitha arsyet e përmendura më lart, ka bazë të arsyeshme të besohet se Ali Kushayb është përgjegjës për krime, sipas neneve 25(3)(a) dhe 25(3)(d) të

Statutit, për kryerjen e krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës, siç specifikohen në pikat vijuese, siç paraqiten në Kërkesën e Prokurorit:

Pika 1

(Persekutimi në fshatrat e Koodom-it dhe zonat përreth përbën krim kundër njerëzimit)

Nga, ose rreth prej 15 gushtit 2003, deri në, ose rreth 31 gushtit 2003, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në persekutimin, kryesisht të popullatës Fur në fshatrat e Koodom-it dhe zonat përreth duke kryer akte të vrasjes, sulme në popullatën civile, shkatërrimin e pronës dhe zhvendosjen e dhunshme (nenet 7(1)(h) dhe 25(3)(d) të Statutit);

Pika 2

(Vrasja e civilëve në fshatrat e Koodom-it dhe zonat përreth përbën krim kundër njerëzimit)

Në, ose rreth 15 gushtit 2003, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në vrasjen e civilëve kryesisht të popullatës Fur të fshatrave të Koodom-it dhe zonave përreth (nenet 7(1)(a) dhe 25(3)(d) të Statutit);

Pika 3

(Vrasja e civilëve në fshatrat e Koodom-it dhe zonat përreth përbën krim lufte)

Në, ose rreth 15 gushtit 2003, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në vrasjen e civilëve kryesisht të popullatës Fur në fshatrat e Koodom-it dhe zonat përreth, ndonëse ata civilë nuk ishin duke marrë pjesë aktive në veprime ushtarake (nenet 8(2)(c)(i) dhe 25(3)(d) të Statutit);

Pika 4

(Vrasja e civilëve në fshatrat e Koodom-it dhe zonat përreth përbën krim kundër njerëzimit)

Në, ose rreth 31 gushtit 2003, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në vrasjen e civilëve kryesisht të popullatës Fur në fshatrat e Koodom-it dhe zonat përreth, (nenet 7(1)(a) dhe 25(3)(d) të Statutit);

Pika 5

(Vrasja e civilëve në fshatrat e Koodom-it dhe zonat përreth përbën krim lufte)

Në, ose rreth 31 gushtit 2003, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në vrasjen e civilëve kryesisht të popullatës Fur në fshatrat e Koodom-it dhe zonat përreth, ndonëse ata civil nuk ishin duke marrë pjesë aktive në veprime ushtarake (nenet 8(2)(c)(i) dhe 25(3)(d) të Statutit);

Pika 6

(Sulmet kundër popullatës civile në fshatrat e Koodom-it dhe zonat përreth përbëjnë krime lufte)

Nga, ose rreth prej 15 gushtit 2003, deri në, ose rreth 31 gushtit 2003, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në kryerjen e sulmeve kundër civilëve, kryesisht të popullatës Fur në fshatrat e Koodom-it dhe zonat përreth dhe kundër civilëve që nuk merrnin pjesë drejtpërdrejt në veprimet ushtarake (nenet 8(2)(e)(i) dhe 25(3)(d) të Statutit);

Pika 7

(Sulmet kundër popullatës civile në fshatrat e Koodom-it dhe zonat përreth përbëjnë krime lufte)

Nga, ose rreth prej 15 gushtit 2003, deri në, ose rreth 31 gushtit 2003, **Ali Kushayb**, së bashku me të tjerët, kreu sulme kundër civilëve, kryesisht të popullatës Fur në fshatrat e Koodom-it dhe zonat përreth dhe kundër civilëve që nuk merrnin pjesë drejtpërdrejt në veprimet ushtarake (nenet 8(2)(e)(i) dhe 25(3)(a) të Statutit);

Pika 8

(Shkatërrimi i pronës në fshatrat e Koodom-it dhe zonat përreth përbën krime lufte)

Nga, ose rreth prej 15 gushtit 2003, deri në, ose rreth 31 gushtit 2003, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në shkatërrimin e pronës, që i përkiste kryesisht popullatës Fur në fshatrat e Koodom-it dhe zonat përreth, përfshirë djegien e shtëpive (nenet 8(2)(e)(xii) dhe 25(3)(d) të Statutit);

Pika 9

(Zhvendosja e dhunshme nga fshatrat e Koodom-it dhe zonat përreth përbën krim kundër njerëzimit)

Nga, ose rreth prej 15 gushtit 2003, deri në, ose rreth 31 gushtit 2003, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në zhvendosjen e dhunshme të afro 20.000 civilëve, kryesisht të popullatës Fur në fshatrat e Koodom-it dhe zonat përreth, që ka rezultuar në braktisjen e fshatrave (nenet 7(1)(d) dhe 25(3)(d) të Statutit);

Pika 10

(Persekutimi në qytetin Bindisi dhe zonat përreth përbën krim kundër njerëzimit)

Në, ose rreth 15 gushtit 2003, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në persekutimin kryesisht të popullatës Fur në qytetin e Bindisit dhe zonat përreth, përmes akteve të vrasjes, dhunimit, sulmeve të popullatës civile, akte jo njerëzore, rrënimin, shkatërrimin e pronës dhe zhvendosjen e dhunshme të popullatës (nenet 7(1)(h) dhe 25(3)(d) të Statutit);

Pika 11

(Vrasja e civilëve në qytetin Bindisi dhe zonat përreth përbën krim kundër njerëzimit)

Në, ose rreth 15 gushtit 2003, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në vrasjen e mbi 100 civilëve kryesisht të popullatës Fur në qytetin e Bindisit dhe zonat përreth, (nenet 7(1)(a) dhe 25(3)(d) të Statutit);

Pika 12

(Vrasja e civilëve në qytetin Bindisi dhe zonat përreth përbën krim lufte)

Në, ose rreth 15 gushtit 2003, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në vrasjen e mbi 100 civilëve kryesisht të popullatës Fur në qytetin e Bindisit dhe zonat përreth, ndonëse ata civilë nuk ishin duke marrë pjesë aktive në veprimet ushtarake (nenet 8(2)(c)(i) dhe 25(3)(d) të Statutit);

Pika 13

(Dhunimet në qytetin Bindisi dhe zonat përreth përbëjnë krime kundër njerëzimit)

Në, ose rreth 15 gushtit 2003, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në dhunimin e grave dhe vajzave kryesisht të popullatës Fur në qytetin e Bindisit dhe zonat përreth, (nenet 7(1)(g) dhe 25(3)(d) të Statutit);

Pika 14

(Dhunimet në qytetin Bindisi dhe zonat përreth përbëjnë krime lufte)

Në, ose rreth 15 gushtit 2003, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në dhunimin e grave dhe vajzave kryesisht të popullatës Fur në qytetin e Bindisit dhe zonat përreth, (nenet 8(2)(e)(vi) dhe 25(3)(d) të Statutit);

Pika 15

(Sulmet kundër popullatës civile në qytetin Bindisi dhe zonat përreth përbëjnë krime lufte)

Në, ose rreth 15 gushtit 2003, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në kryerjen e sulmeve kundër civilëve kryesisht të popullatës Fur në qytetin e Bindisit dhe zonat përreth, ndonëse ata civilë nuk ishin duke marrë pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në veprimet ushtarake (nenet 8(2)(e)(i) dhe 25(3)(d) të Statutit);

Pika 16

(Sulmet kundër popullatës civile në qytetin Bindisi dhe zonat përreth përbëjnë krime lufte)

Në, ose rreth 15 gushtit 2003, **Ali Kushayb**, së bashku me të tjerët, kreu sulme kundër civilëve kryesisht të popullatës Fur në qytetin e Bindisit dhe zonat përreth, ndonëse ata civilë nuk ishin duke marrë pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në veprimet ushtarake (nenet 8(2)(e)(i) and 25(3)(a) të Statutit);

Pika 17

(Aktet çnjerëzore në qytetin Bindisi dhe zonat përreth përbëjnë krime kundër njerëzimit)

Në, ose rreth 15 gushtit 2003, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në shkaktimin e vuajtjeve të mëdha, lëndimeve serioze trupore ose mendore, ose shëndetit fizik, përmes akteve çnjerëzore në civilët kryesisht të popullatës Fur në qytetin e Bindisit dhe zonat përreth përfshirë aktet çnjerëzore të të shtënave, që rezultuan me lëndime serioze (nenet 7(1)(k) dhe 25(3)(d) të Statutit);

Pika 18

(Rrënimet në qytetin Bindisi dhe zonat përreth përbëjnë krime lufte)

Në, ose rreth 15 Gushtit 2003, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në rrënimin e pronës që i takonte kryesisht të popullatës Fur në qytetin e Bindisit dhe zonat përreth, përfshirë rrënimin e ekonomive familjare (nenet 8(2)(e)(v) dhe 25(3)(d) të Statutit);

Pika 19

(Shkatërrimi i pronës në qytetin e Bindizit dhe zonat përreth përbëjnë krime lufte)

Në, ose rreth 15 gushtit 2003, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në shkatërrimin e pronës që i takonte kryesisht popullatës Fur në qytetin e Bindisit dhe zonat përreth, përfshirë djegien e depove ushqimore, xhamisë dhe vendbanimet në zonë (nenet 8(2)(e)(xii) dhe 25(3)(d) të Statutit);

Pika 20

(Zhvendosja e dhunshme nga qyteti Bindizi dhe zonat përreth përbëjnë krim kundër njerëzimit)

Në, ose rreth 15 gushtit 2003, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në zhvendosjen e dhunshme të afro 34.000 civilëve, kryesisht Fur, në qytetin e Bindisit dhe zonat përreth, që ka rezultuar në braktisjen e qytetit (nenet 7(1)(d) dhe 25(3)(d) të Statutit);

Pika 21

(Persekutimi në qytetin Mukjar dhe zonat përreth përbëjnë krim kundër njerëzimit)

Në periudhën midis gushtit 2003 dhe marsit 2004, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në persekutimin, kryesisht të popullatës Fur të qytetit Mukjar dhe zonave përreth përmes akteve të vrasjes, sulmeve në popullatën civile, burgosjes ose heqjes së lirive, torturave, rrënimeve dhe shkatërrimit të pronës (nenet 7(1)(h) dhe 25(3)(d) të Statutit);

Pika 22

(Vrasja e meshkujve në qytetin Mukjar dhe zonat përreth përbën krim kundër njerëzimit)

Në periudhën midis shtatorit 2003 dhe tetorit 2003, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në vrasjen e të paktën 20 meshkujve kryesisht të popullatës Fur të qytetit Mukjar dhe zonave përreth (nenet 7(1)(a) dhe 25(3)(d) të Statutit);

Pika 23

(Vrasja e meshkujve në qytetin Mukjar dhe zonat përreth përbën krim lufte)

Në periudhën midis shtatorit 2003 dhe tetorit 2003, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në vrasjen e të paktën 20 meshkujve kryesisht të popullatës Fur të qytetit Mukjar dhe zonave përreth, ndonëse ata meshkuj nuk merrnin pjesë aktive në veprimet ushtarake (nenet 8(2)(c)(i) dhe 25(3)(d) të Statutit);

Pika 24

(Vrasja e meshkujve në qytetin Mukjar dhe zonat përreth përbën krim kundër njerëzimit)

Në, ose rreth dhjetorit 2003, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në vrasjen e të pakën 21 meshkujve kryesisht të popullatës Fur të qytetit Mukjar dhe zonave përreth (nenet 7(1)(a) dhe 25(3)(d) të Statutit);

Pika 25

(Vrasja e meshkujve në qytetin Mukjar dhe zonat përreth përbën krim kundër njerëzimit)

Në, ose rreth dhjetorit 2003, **Ali Kushayb**, së bashku me të tjerët, kreu vrasjen e të paktën 21 meshkujve kryesisht të popullatës Fur të qytetit Mukjar dhe zonave përreth duke i transportuar ata me roje të armatosura deri tek vendi i ekzekutimit (nenet 7(1)(a) dhe 25(3)(a) të Statutit);

Pika 26

(Vrasja e meshkujve në qytetin Mukjar dhe zonat përreth përbën krim lufte)

Në, ose rreth dhjetorit 2003, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në vrasjen e të paktën 21 meshkujve kryesisht të popullatës Fur të qytetit Mukjar dhe zonave përreth, ndonëse ata nuk kishin marrë pjesë aktive në veprimet ushtarake (nenet 8(2)(c)(i) and 25(3)(d) të Statutit);

Pika 27

(Vrasja e meshkujve në qytetin Mukjar dhe zonat përreth përbën krim lufte)

Në, ose rreth dhjetorit 2003, **Ali Kushayb**, së bashku me të tjerët, kreu vrasjen e të paktën 21 meshkujve kryesisht të popullatës Fur të qytetit Mukjar dhe zonave përreth, ndonëse ata nuk kishin marr pjesë aktive në veprimet ushtarake, duke i transportuar ata me roje të armatosura deri tek vendi i ekzekutimit (nenet 8(2)(c)(i) dhe 25(3)(a) të Statutit);

Pika 28

(Vrasja e meshkujve në qytetin Mukjar dhe zonat përreth përbën krim kundër njerëzimit)

Në, ose rreth marsit 2004, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në vrasjen e të paktën 32 meshkujve kryesisht të popullatës Fur të qytetit Mukjar dhe zonave përreth (nenet 7(1)(a) dhe 25(3)(d) të Statutit);

Pika 29

(Vrasja e meshkujve në qytetin Mukjar dhe zonat përreth përbën krim kundër njerëzimit)

Në, ose rreth marsit 2004, **Ali Kushayb**, së bashku me të tjerët, kreu vrasjen e të paktën 32 meshkujve kryesisht të popullatës Fur të qytetit Mukjar dhe zonave përreth duke i transportuar ata me roje të armatosura deri tek vendi i ekzekutimit (nenet 7(1)(a) dhe 25(3)(a) të Statutit);

Pika 30

(Vrasja e meshkujve në qytetin Mukjar dhe zonat përreth përbën krim lufte)

Në, ose rreth Marsit 2004, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në vrasjen e të paktën 32 meshkujve kryesisht të popullatës Fur të qytetit Mukjar dhe zonave përreth, ndonëse ata nuk kishin marrë pjesë aktive në veprimet ushtarake (nenet 8(2)(c)(i) dhe 25(3)(d) të Statutit);

Pika 31

(Vrasja e meshkujve në qytetin Mukjar dhe zonat përreth përbën krim lufte)

Në, ose rreth marsit 2004, **Ali Kushayb**, së bashku me të tjerët, kreu vrasjen e të paktën 32 meshkujve kryesisht të popullatës Fur të qytetit Mukjar dhe zonave përreth, ndonëse ata nuk kishin marrë pjesë aktive në veprimet ushtarake, duke i transportuar ata me roje të armatosura deri tek vendi i ekzekutimit (nenet 8(2)(c)(i) dhe 25(3)(a) të Statutit);

Pika 32

(Sulmet kundër popullatës civile në qytetin Mukjar dhe zonat përreth përbëjnë krim lufte)

Në periudhën midis gushtit 2003 dhe marsit 2004, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në kryerjen e sulmeve kundër civilëve kryesisht të popullatës Fur të qytetit Mukjar dhe zonave përreth, dhe kundër civilëve të cilët nuk merrnin pjesë në mënyrë aktive në veprimet ushtarake (nenet 8(2)(e)(i) dhe 25(3)(d) të Statutit);

Pika 33

(Sulmet kundër popullatës civile në qytetin Mukjar dhe zonat përreth përbëjnë krim lufte)

Në periudhën midis gushtit 2003 dhe marsit 2004, **Ali Kushayb**, së bashku me të tjerët, kreu sulme kundër civilëve kryesisht të popullatës Fur të qytetit Mukjar dhe zonave përreth, dhe kundër civilëve të cilët nuk merrnin pjesë në mënyrë aktive në veprimet ushtarake (nenet 8(2)(e)(i) dhe 25(3)(a) të Statutit);

Pika 34

(Burgosja ose heqjet e dhunshme të lirive në qytetin Mukjar dhe zonat përreth përbëjnë krim kundër njerëzimit)

Në fillim të, ose rreth gushtit 2003, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në burgosjen ose heqjen e dhunshme të lirive fizike të të paktën 400 civilëve kryesisht të popullatës Fur të qytetit Mukjar dhe zonave përreth (nenet 7(1)(e) dhe 25(3)(d) të Statutit);

Pika 35

(Torturat në qytetin Mukjar dhe zonat përreth përbëjnë krim kundër njerëzimit)

Në fillim të, ose rreth gushtit 2003, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në torturimin e të paktën 60 civilëve kryesisht të popullatës Fur të qytetit Mukjar dhe zonave përreth (nenet 7(1)(f) dhe 25(3)(d) të Statutit);

Pika 36

(Grabitjet në qytetin Mukjar dhe zonat përreth përbëjnë krim lufte)

Në periudhën midis gushtit 2003 dhe marsit 2004, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në grabitjen e pronës që i takonte kryesisht popullatës Fur të qytetit Mukjar dhe zonave përreth përfshirë grabitjen e shitoreve, shtëpive, dhe gjësë së gjallë (nenet 8(2)(e)(v) dhe 25(3)(d) të Statutit);

Pika 38

(Shkatërimi i pronës në qytetin Mukjar dhe zonat përreth përbën krim lufte)

Në periudhën midis gushtit 2003 dhe marsit 2004, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në shkatërimin e pronës që i takonte kryesisht popullatës Fur të qytetit Mukjar dhe zonave përreth përfshirë djegien e vendbanimeve dhe shkatërimin e të korrave dhe fermave (nenet 8(2)(e)(xii) dhe 25(3)(d) të Statutit);

Pika 39

(Persekutimi në qytetin Arawala dhe zonat përreth përbën krim kundër njerëzimit)

Në, ose rreth dhjetorit 2003, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në persekutimin kryesisht të popullatës Fur të qytetit Arawala dhe zonave përreth, përmes akteve të vrasjes, dhunimeve, sulmeve në popullatën civile, nëpërkëmbjes së dinjitetit personal, akteve çnjerëzore, grabitjeve, shkatërrimit të pronave dhe zhvendosjes së dhunshme të popullatës (nenet 7(1)(h) dhe 25(3)(d) të Statutit);

Pika 40

(Vrasja e civilëve në qytetin Arawala dhe zonat përreth përbën krim kundër njerëzimit)

Në, ose rreth Dhjetorit 2003, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në vrasjen e të paktën 26 civilëve kryesisht të popullatës Fur të qytetit Arawala dhe zonave përreth, (nenet 7(1)(a) dhe 25(3)(d) të Statutit);

Pika 41

(Vrasja e civilëve në qytetin Arawala dhe zonat përreth përbën krim lufte)

Në, ose rreth dhjetorit 2003, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në vrasjen e të paktën 26 meshkujve kryesisht të popullatës Fur të qytetit Arawala dhe zonave përreth, ndonëse ata nuk kishin marrë pjesë aktive në veprimet ushtarake (nenet 8(2)(c)(i) and 25(3)(d) të Statutit);

Pika 42

(Përdhunimet në qytetin Arawala dhe zonat përreth përbëjnë krim kundër njerëzimit)

Në, ose rreth dhjetorit 2003, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në përdhunimin e të paktën 10 grave dhe vajzave kryesisht të popullatës Fur të qytetit Arawala dhe zonave përreth (nenet 7(1)(g) and 25(3)(d) të Statutit);

Pika 43

(Përdhunimet në qytetin Arawala dhe zonat përreth përbëjnë krim lufte)

Në, ose rreth Dhjetorit 2003, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në përdhunimin e të paktën 10 grave dhe vajzave kryesisht të popullatës Fur të qytetit Arawala dhe zonave përreth (nenet 8(2)(e)(vi) dhe 25(3)(d) të Statutit);

Pika 44

(Sulmet kundër popullatës civile në qytetin Arawala dhe zonat përreth përbëjnë krim lufte)

Në, ose rreth dhjetorit 2003, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në kryerjen e sulmeve kundër civilëve, kryesisht të popullatës Fur të qytetit Arawala dhe zonave përreth, dhe kundër civilëve të cilët nuk merrnin pjesë në mënyrë aktive në veprimet ushtarake (nenet 8(2)(e)(i) dhe 25(3)(a) të Statutit);

Pika 45

(Sulmet kundër popullatës civile në qytetin Arawala dhe zonat përreth përbëjnë krim lufte)

Në, ose rreth dhjetorit 2003, **Ali Kushayb**, së bashku me të tjerët, kreu sulme kundër civilëve kryesisht të popullatës Fur të qytetit Arawala dhe zonave përreth, dhe kundër civilëve të cilët nuk merrnin pjesë në mënyrë aktive në veprimet ushtarake (nenet 8(2)(e)(i) dhe 25(3)(a) të Statutit);

Pika 46

(Nëpërkëmbja e dinjitetit personal në qytetin Arawala dhe zonat përreth përbën krim lufte)

Në, ose rreth dhjetorit 2003, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në nëpërkëmbjen e dinjitetit personal të të paktën 10 grave dhe vajzave kryesisht të popullatës Fur të qytetit Arawala dhe zonave përreth, (nenet 8(2)(c)(ii) dhe 25(3)(d) të Statutit);

Pika 47

(Nëpërkëmbja e dinjitetit personal në qytetin Arawala dhe zonat përreth përbën krim lufte)

Në, ose rreth dhjetorit 2003, **Ali Kushayb**, së bashku me të tjerët, nëpërkëmbi dinjitetin personal, të të paktën 10 grave dhe vajzave kryesisht të popullatës Fur të qytetit Arawala dhe zonave përreth, (nenet 8(2)(c)(ii) dhe 25(3)(a) të Statutit);

Pika 48

(Aktet çnjerëzore në qytetin Arawala përbëjnë krime kundër njerëzimit)

Në, ose rreth dhjetorit 2003, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në shkaktimin e vuajtjeve të mëdha, lëndimeve serioze trupore ose mendore, ose shëndetit fizik, përmes akteve çnjerëzore në civilët kryesisht të popullatës Fur të qytetit Arawala dhe në zonat përreth (nenet 7(1)(k) dhe 25(3)(d) të Statutit);

Pika 49

(Grabitjet në qytetin Mukjar dhe zonat përreth përbëjnë krim lufte)

Në, ose rreth dhjetorit 2003, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në grabitjen e pronës që i takonte kryesisht popullatës Fur të qytetit Arawal dhe zonave përreth përfshirë grabitjet e shitoreve, shtëpive, dhe gjësë së gjallë (nenet 8(2)(e)(v) dhe 25(3)(d) të Statutit);

Pika 50

(Shkatërrimi i pronës në qytetin Arawal dhe zonat përreth përbën krim lufte)

Në, ose rreth dhjetorit 2003, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në shkatërrimin e pronës që i takonte kryesisht popullatës Fur të qytetit Mukjar dhe zonave përreth përfshirë shkatërrimin e shumicës së qytetit Arawala (nenet 8(2)(e)(xii) dhe 25(3)(d) të Statutit);

Pika 51

(Zhvendosja e dhunshme nga qyteti Arawala dhe zonat përreth përbën krim kundër njerëzimit)

Në, ose rreth dhjetorit 2003, **Ali Kushayb**, si pjesë e grupit të personave që vepruan me qëllime të përbashkëta, kontribuoi në zhvendosjen e dhunshme të afro 7000 civilëve, kryesisht të popullatës Fur të qytetit Arawala dhe zonat përreth qyteteve në qytetet Deleig, Garsila dhe në vende të tjera, duke rezultuar në braktisjen e qytetit (nenet 7(1)(d) dhe 25(3)(d) të Statutit);

DUKE KONSIDERUAR që ka bazë të arsyeshme të besohet se arrestimi i Ali Kushayb-it duket të jetë i domosdoshëm në këtë fazë, për të siguruar paraqitjen e tij para Gjykatës, sipas kuptimit të nenit 58(1)(b)(i) të Statutit;

PËR KËTO ARSYE

NË KËTË MËNYRË LËSHON:

FLETË ARRESTI për Ali Muhammad Ali ABD-AL-RAHMAN, gjithashtu i njohur si **ALI KUSHAYB**; personi që besohet të jetë afërsisht 50 vjeçar, shtetas i Sudanit; babai i të cilit është nga fisi Taisha (Taicha) dhe nëna e të cilit është nga fisi Dangaoui, nga jugu i Sudanit, i

cili besohet të jetë lider i fisit dhe anëtar i PDF-së, i cili ishte “aqid al-ogada” (kolonel i kolonelëve) për tërë zonën Wadi Salih në Darfur; i cili besohet të ketë qenë një ndër komandantët kryesor të Milicisë/Janjaweed; i cili për momentin besohet të jetë nën arrestin e Policisë Sudaneze, në bazë të një urdhër-arresti të lëshuar nga autoritetet Sudaneze në prill 2005 dhe të zbatuar më 28 nëntor 2006; emrat e të cilit shqiptohen si: Ali Kosheib, Ali Kouchib, Ali Mohamed, Ali Kosheb, Koshib dhe Ali Koship.

Përgatitur në të dy gjuhët Anglisht dhe Frëngjisht, kështu që versioni në gjuhën angleze është autoritar.

[Nënshkrimi elektronik]

**Gjyqtare Akua Kuenyehia
Kryetare e Trupit Gjykses**

[Nënshkrimi elektronik]

Gjyqtar Claude Jorda

Gjyqtare Sylvia Steiner

E Premte, 27 Prill 2007

Në Hagë, Holandë